



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRATË E ARSIMIT, SHKENÇËS DHE TEKNOLOGjisë	UNIVERSITETI UNIVERSITY “HAXHI ZEKA” PEJË
REKTORATI	
Nr. i Br. / No. <u>374</u>	Nr. i faqi Br. str / No. pg. <u>9</u>
Data / Datum / Date: <u>28/02/2022</u>	

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
“HAXHI ZEKA”

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA”

Manual për vendosjen e standardeve për rangimin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Webometrics

I. Parathënie

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë harton manualin për Vendosjen e Standardeve për Rangimin e institucionit në Webometrics. Ky manual është përgatitur për t'i shërbyer institucionit, stafit dhe studentëve të cilët janë të interesuar të kontribuojnë në ngritjen e performancës së institucionit me qëllim të rangimit sa më të lartë.

Manuali do të shërbej si udhëzues për të drejtuar punën e sistemit institucional në fushën e informimit dhe promovimit të aktiviteteve për kriteret dhe hapat që duhet ndjekur për të përfituar cilësi të lartë institucionale. Po ashtu do të shërbej si informatorë për palët e interest të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në promovimin e institucionit. Në manual janë të përfshirë: qëllimi i manualit, kriteret e vlerësimit, përgjegjësitet e mekanizmit mbikëqyrës, stafit dhe studentëve të institucionit, periudha e zbatimit të aktivitetetve të caktuara, dhe formularët e nevojshëm për aktivitetet e akterëve kyç.

Manuali është dokument dinamik që mund të ndryshojë varësisht prej nevojave të institucionit si dhe kritereve të rangimit në Webometrics.

II. Qëllimi i manualit

Qëllimi kryesor i këtij Manuali është vendosja e Standardeve për Rangimin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Webometrics si dhe krijimi i një mekanizmi efektiv dhe efikas për të ndihmuar në ngritjen e performancës së institucionit. Me këtë dokument parashihet si aktiviteti kyç promovimi sa më i mirë i institucionit përmes aktiviteteve që realizohen brenda institucionit nga ana e akterëve potencial. Prandaj rëndësia e ngritisë së performancës së institucionit bazohet në vlerën e shtuar e që është e domosdoshme

për t'u identifikuar kombëtarisht dhe ndërkombe tarisht. Andaj, nëpërmjet këtij manuali synohet efektshmëria, efikasiteti dhe relevanca.

III. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit përfshijnë disa aktivitete që mund të ndihmojnë në rritjen e performancës së institucionit, dhe atë:

1. **Trafiku në faqen zyrtare (www.unhz.eu)** – Përdorimi i shpesht i faqes zyrtare;
2. **Local SEO** – Optimizim në mënyrë lokale;
3. **Fjalët kyçe (Keywords)** - Përdorimi i fjalëve kyçe në tekste promovuese nga 20% deri 50%;
4. **Back links** – Nënkupton lidhjet, vegëzat (linqe) në faqet e internetit të ndryshme nga tuajat që kthehen në një nga faqet në ueb faqen tuaj. Backlinks quhen gjithashtu lidhje hyrëse sepse ato përfshijnë trafikun e një ueb faqe tjetër të internetit që vjen në ueb faqen e juaj. Cilësia dhe sasia e lidhjeve tuaja mund t'ju ndihmojnë të renditeni më lartë në motorët e kërkimit si Google dhe Bing apo SEO;
5. **Email marketing** – Nënkupton dërgimin e postave elektronike në mënyrë të shpeshtuar;
6. **FAQs Pyetjet më të shpeshta?** – Nënkupton kategorinë e pyetjeve më të shpeshta të parashtruara (kategoria e veçantë);
7. **Punimet shkencore** – Nënkupton krijimin e menysë së veçantë ku do të publikohen punimet shkencore të stafit sipas manualit të caktuar (shiko shtojcën);
8. **Punimet (abstrakte) nga konferencat** – Nënkupton krijimin e menysë së veçantë ku do të publikohen punimet (abstraktet) e stafit nga konferencat sipas manualit të caktuar (shiko shtojcën);
9. **Aktivitetet e stafit** - Nënkupton krijimin e menysë së veçantë ku do të publikohen të gjitha aktivitete të stafit;
10. **Aktivitetet e stafit në bashkëpunim me studentë** – Krijimi i menysë së veçantë ku do të publikohen punimet e stafit në bashkëpunim me studentë sipas manualit të caktuar (shiko shtojcën);
11. **Blog për studentë** – Krijimi i menysë për publikimin e Eseve të studentëve sipas manualit të caktuar (shiko shtojcën);
12. **Histori suksesi të studentëve (ALUMNI)** – Krijimi i menysë së veçantë për publikimin e historive të suksesit të studentëve të diplomuar;
13. **Citimet** – Çdo palë në kuadër të institucionit është i obliguar të paraqitet me emrin e institucionit duke e përfshirë edhe vegëzen e ueb faqes (Universiteti Haxhi Zeka, www.unhz.eu) në mënyrë që të rritet numri i citimeve të institucionit;
14. **EMPIRIKUS** – Nënkupton krijimin e menysë së veçantë ku do të publikohen të gjitha vëllimet e revistës ekzistuese EMPIRUKUS (revista Administrim biznesi).

IV. Udhëzues për krijimin e platformave individuale në LinkedIn dhe Google Scholar

Me qëllim të ngritjes së performancës së institucionit, stafi i rregullt e ka për detyrë që të krijoj profilet individuale në platformat Facebook, LinkedIn dhe Google Scholar.

Facebook është një faqe e rrjeteve sociale që e bën të lehtë lidhjen dhe shkëmbimin e informatave në internet. Të gjithë akterë në kuadër të institucionit janë të obliguar si në vijim:

1. Stafi i universitetit duhet të shënoj që është duke punuar në Universitetin "Haxhi Zeka", duke e përfshirë edhe vegëzen e faqes zyrtare (www.unhz.eu);
2. Studentët duhet të shënojnë që janë duke studuar apo kanë qenë student në Universitetin "Haxhi Zeka" duke e përfshirë edhe vegëzen e faqes zyrtare (www.unhz.eu).

LinkedIn profili është platformë ku ju mund të ndërtoni profilin tuaj profesional, të shfaqni arritjet dhe aftësitë tuaja, të ndani përbajtje me profesionistë të tjera dhe të lidheni me kolegët, partnerët e biznesit dhe punëdhënësit e mundshëm. Po ashtu secili akterë në kuadër të institucionit është i obliguar të vendos në profilin e tij të LinkedIn që është duke punuar apo studioni në UHZ.

Google Scholar është interfejs i Google-it që e bën më të lehtë kërkimin akademik dhe aktivitete tjera shkencore. Ai është krijuar përfshirë kërkuar artikuj shkencorë si:

- | | |
|---------------|----------|
| 1. Revista | 4. Libër |
| 2. Konferenca | 5. Teza |
| 3. Kapituj | 6. etj. |

Google Scholar është i dobishëm sepse:

- Renditja e rezultateve ndikohet nga numri i citimeve;
- Kërkimet dhe filtrimi i rezultateve mund të bëhen më lehtë;
- Ju lejohet të gjurmoni rezultatet e reja në kërkimin tuaj dhe citimet e reja në artikujt tuaj.

Andaj, i gjithë stafi i Universitetit "Haxhi Zeka" është i obliguar që të posedojë këto dy profile, si dhe të paraqitet me emrin e institucionit duke e përfshirë edhe vegëzen e web faqes (Universiteti Haxhi Zeka, www.unhz.eu).

V. Hapat që duhet ndjekur për të kontribuar në rritjen e performancës

Për të realizuar njërin nga aktivitetet e cekura më lartë, ju duhet të veproni si në vijim:

Për stafin e UHZ-së:

Hapi 1: Të plotësohet formulari nga ana e stafit (sipas kategorive të definuar);

Hapi 2: Të përcjellët aktiviteti në posta elektronike: butrint.xhemajli@unhz.eu, cc. adnan.lataj@unhz.eu dhe suada.ajdarpasic@unhz.eu

Hapi 3: Të njoftohet Zyra për Kërkime Shkencore për çdo aktivitet shkencor që realizohet apo është duke u realizuar (suada.ajdarpasic@unhz.eu);

Hapi 4: Nëse keni nevojë për ndihmë shtesë, mund të konsultoheni me Koordinatorin për Kërkime Shkencore (suada.ajdarpasic@unhz.eu).

Për studentët e UHZ-së:

Hapi 1: Të plotësohet formulari nga ana e studentit (sipas kategorive të definuar);

Hapi 2: Të përcjellët aktiviteti për recension në posta elektronike: butrint.xhemajli@unhz.eu, cc. adnan.lataj@unhz.eu dhe suada.ajdarpasic@unhz.eu

Hapi 3: Të njoftohet Zyra për Kërkime Shkencore për çdo aktivitet shkencor që realizohet apo është duke u realizuar (suada.ajdarpasic@unhz.eu);

Hapi 4: Nëse keni nevojë për ndihmë shtesë, mund të konsultoheni me Koordinatorin për Kërkime Shkencore (suada.ajdarpasic@unhz.eu).

VI. Periudha e vlerësimit

Vlerësimi i performancës së institucionit nga ana e platformës së Webometrics ndodh dy herë brenda një viti, dhe atë:

1. Në janar të çdo viti; dhe
2. Në qershor të çdo viti.

Afate kohore të aktiviteteve brenda institucionit janë si në vijim:

Përshkrimi i Aktiviteteve	Afati kohor	Akteri
Trafiku në ueb faqe	Vazhdimesht	1.Të gjithë brenda institucionit 2.Jashtë institucionit
Publikimi i aktiviteteve	Vazhdimesht	Të gjithë brenda institucionit
Publikimi i punimeve shkencore	Vazhdimesht	Stafi dhe studentë
Publikimi i punimeve (abstrakteve) nga konferanca	Vazhdimesht	Stafi dhe studentë
Aktivitetet shkencore të stafit	Vazhdimesht	Stafi
Aktivitetet e stafit në bashkëpunim me student	Vazhdimesht	Stafi dhe studentë
Publikimi i ESEVE të studentëve	Vazhdimesht	Studentët
Histori suksesi të studentëve	Vazhdimesht	ALUMNI

VII. Mekanizmi mbikëqyrës për zbatimin e manualit

Për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij manuali do të përkujdeset Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Dekanët e njësive akademike janë të obliguar që të raportojnë për stafin e tyre lidhur më respektimin e standardeve të vendosura në këtë manual dy herë në vit:

1. Në muajin mars të çdo viti; dhe
2. Në muajin nëntor të çdo viti.

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit është i obliguar që të raportoj për stafin administrativ lidhur më respektimin e standardeve të vendosura në këtë manual dy herë në vit:

1. Në muajin mars të çdo viti; dhe
2. Në muajin nëntor të çdo viti.


Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit është i obliguar që të raportoj për studentët e UHZ - së lidhur më respektimin e standardeve të vendosura në këtë manual dy herë në vit:

1. Në muajin mars të çdo viti; dhe
2. Në muajin nëntor të çdo viti.

Të gjitha raportet duhet që të dorëzohen të Prorektori Për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore dhe Koordinatori për Kërkime Shkencore.

Prorektori Për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore dhe Koordinatori për Kërkime Shkencore në bashkëpunim më zyrën e IT - së, në bazë të raporteve që kanë dërguar njësitë akademike, studentët dhe stafi administrativ i

raportojnë Rektorit të UHZ - së për zbatimin e manualit dhe i rekomandojnë për hapat që duhet të ndërmerren.



VIII. Shtojca

1. Manuali për punim shkencore

(Emri i revistës në Header)

TITLE (CENTURY GOTHIC, CAPITAL LETTER, 11 PT, CENTER)

Name and surname¹ (century gothic, 10 pt, center)

Name and surname²

ABSTRACT

Century Gothic, 11 pt, Justified, 1.5 hapësira mes rreshtave, hapësira automatike mes paragrafave AUTO.

Keywords: Keyword 1, Keyword 2, Keyword 3, Keyword 4, Keyword 5. (century gothic, 10 pt, justified)

¹ Emri dhe mbiemri, [email](#), linku i punimit, ORCID, Fakulteti, Universiteti "Haxhi Zeka", [www.unhz.eu](#), Pejë, Republika e Kosovës.

² Emri dhe mbiemri, [email](#), linku i punimit, ORCID, Fakulteti, Universiteti "Haxhi Zeka", [www.unhz.eu](#), Pejë, Republika e Kosovës.

2. Manual për punim (apstrakt) për konferencë ndërkombtare

Tituli (Century Gothic, Bold, 12 pt, Center)¹

Emri dhe mbiemri¹, Emri dhe mbiemri² (**century gothic, 10 pt, center**)

¹Institucioni, www.unhz.eu, Adresa, Qyteti, Shteti (**century gothic, 10 pt, center**)

² Institucioni, www.unhz.eu, Adresa, Qyteti, Shteti (**century gothic, 10 pt, center**)

Abstrakt

Century Gothic, 11 pt, Justified, 1.5 hapësira mes rreshtave, hapësira automatike mes paragrafave AUTO.

Fjalët kyçë: fjala kyçë 1, fjala kyçë 2 (max. pesë fjalë kyçë). (**century gothic, 10 pt, justified**)

¹ Emri i konferencës, linku i konferencës

3. Manual për ESE

TITULI (Century Gothic, 12 PT, CENTER)

Emri dhe mniemri¹ (century gothic, 10 pt, center)

Hyrje (century gothic, 11 pt, left)

Hyrja duhet të përbajë 350 – 500 fjalë, Century Gothic, 11 pt, Justified, 1.5 hapësira mes rreshtave, hapësira automatike mes paragrafave AUTO, citimi i literaturës të jetë në APA stil.

Shtjellimi (century gothic, 11 pt, left)

Shtjellimi duhet të përbaj 1500 – 2000 fjalë, Century Gothic, 11 pt, Justified, 1.5 hapësira mes rreshtave, hapësira automatike mes paragrafave AUTO.

Konkluzioni (century gothic, 11 pt, left)

Konkluzioni duhet të përbaj 300 – 400 fjalë, Century Gothic, 11 pt, Justified, 1.5 hapësira mes rreshtave, hapësira automatike mes paragrafave AUTO.

¹ Emri dhe mbiemri, [email](#), Fakulteti, Departamenti, Universiteti "Haxhi Zeka", [www.unhz.eu](#), Pejë, Republika e Kosovës.